


**NJËSIA E VETADMINISTRIMIT LOKAL
KOMUNA DIBËR**

РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISE
ОПШТИНА ДЕБАР - KOMUNA DIBËR
ГРАДОНАЧАЛНИК - KRYETARI
Бр.Нр. 10-1259/1
30.12. 2019 год.виш
ДЕБАР - DIBËR



**PROGRAMI VJETOR
NJËSIA PËR MBIKËQYERJE INSPEKTUESE
PËR PUNËN E INSPEKTORIT TË AUTORIZUAR PËR NDËRTIM
PËR VITIN 2020**

DIBËR – DHJETOR 2019

Në mbështetje të nenit 50 paragrafi 1 të Ligjit për vetëqeverisje lokale („, Gazeta zyrtare e Republika e Maqedonisë “ nr. 5/02), nenit 44 të Statutit të Komunës Dibrë, („, Gazeta zyrtare e Komunës Dibrës “ nr. 14/03), neni 33 paragrafi (1) në lidhje me nenin 26 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbikëqyrje inspektuese („, Gazeta zyrtare e Republika e Maqedonisë së Veriut“ nr.102/2019) , Kryetari i Komunës Dibrë sjell Programin Vjetor për punën e Njesisë për mbikëqyerje inspektuese për vitin në vijim - gjegjësisht për periudhën nga 01.01.2020 deri 31.12.2020

PROGRAMI VJETOR

Për punë e Njesisë për mbikëqyerje inspektuese
Të Komunës Dibrë për vitin 2020

HYRJE – KORNIZAT LIGJORE

Komform neni 33 paragrafi (1) në lidhje me nenin 26 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbikëqyrje inspektuese („, Gazeta zyrtare e Republika e Maqedonisë së Veriut“ nr.102/2019) miratohet Programi vjetor për punë e Njesisë për mbikëqyerje inspektimi pranë Komunës Dibrë për vitin 2020 në lidhje me kryerjen të punëve të inspektimit mbikëqyrës pranë kësaj Komune në përputhje me dispozitat ligjore me të cilat rregullohen çështjet nga fusha e ndërtimtarisë, ekologjisë dhe për veprimtari të inspektimit komunal.

Në Programin vjetor janë paraqitur aktivitetet e Njesisë për mbikëqyrje inspektimi që duhet të ndërmerren nga inspektorët e autorizuar të cilët janë pjesë e kësaj njësie:

- I. INSPEKTOR I AUTORIZUAR I NDËRTIMIT
- II. INSPEKTOR I AUTORIZUAR I EKOLOGJISË
- III. INSPEKTOR I AUTORIZUAR KOMUNAL

Punët e mbikëqyrjes inspektuese , Inspektorët e autorizuar nga Njësia për mbikëqyerje inspektuese pranë Komunës Dibrë do t'i kryejnë në përputhje me dispozitat e :

- Ligjit për ndërtim
- Ligjit për hapsirë dhe planifikim urbanistik
- Ligjit për tokë - vend ndërtimi ;
- Ligjit për higjenë komunale ,
- Ligjit për veprimtari komunale
- Ligjit për furnizim me ujë të pijshëm dhe largimin e ujrave të ndotura urbane ;
- Ligjit për menaxhimin me mbeturinat ;
- Ligjit për varreza dhe shërbime varrimi ;
- Ligjit për emërtimin e rrugëve , shesheve , urave dhe infrastrukturave banesore ;
- Ligjit për mbikëqyrje inspektimi ,
- Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative ,
- Ligjit për kundërvatje
- Kodin penal
- Ligjit për parashtrësia dhe propozim
- Ligjit për vetëqeverisje lokale
- Ligjit për nënpunës shtetror
- Ligjit për bashkupunim ndërkomunal
- Ligjit për mjedisin jetësor
- Ligjit për kualitetin e ajrit
- Aktet nëligjore të miratuara nga ministritë kompetente dhe Këshillin e Komunës Dibrë

I. QËLLIMET DHE PARIMET E PËRGJITHSHME E VEPRIMIT TË INSPEKTORËVE TË AUTORIZUAR

- Inspektorët e autorizuar (në tekstin e mëtuftjeshëm inspektorët) kryejnë mbikëqyrjen inspektimi mbi ligjshmërinë , kryerjes së punëve të cilat janë në kompetencë të komunës, në përputhje me dispozitat ligjore, rregullat - nënligjore dhe aktet e përgjithshme në RM.
- Inspektorët e kryejnë mbikëqyrjen inspektuese me qëllim të mbrojtjes së interes publik të personave fizik dhe juridik kur ajo është në pajtushmëri me interes publike.
- Inspektorët në kryerjen e mbikëqyrjes së inspektimit sigurojnë zbatim të njëjtë , të paanshëm dhe efikas (objektiv) të ligjeve dhe dispozitave tjera.
- Realizim me kohë , efikas dhe ekonomik të të drejtave dhe interesave të qytetarëve dhe pjesëmarrësve tjerë në procedurën administrative në zgjedhjen e punëve administrative dhe veprim në afate ligjore ;
- vendosja e afateve ligjore të përcaktuara me procedurë në shkallën e parë dhe të dytë dhe brenda afateve të përcaktuara nga organet gjyqësore ;
- Inspektorët janë të pamvarur në kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese dhe vendimet që do t'i marrin gjatë inspektimit si dhe masat që do të shqiptojnë pas inspektimit të kryer ;
- Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, nëse ka mangësi inspektorët ndërmarrin vetëm ato masa inspektuese në pajtim me ligjin , të cilat janë të domosdoshme për menjanimin e mangësive të konstatuara gjatë mbikëqyrjes të kryer , me kujdes të veçantë që të mos pengohet funksionimi efikas i subjektit të mbikëqyrjes.
- Përfshirjen me kohë në procedurëntë palëve të interesuar me qëllim të mbrojtjes të të drejtave të rëndësishme dhe të interesave të tyre.
- Sigurimin e provave sipas detyrës zyrtare me qëllim e kryerjes zhvillimit të procedurës inspektuese
- Gjatë përcatimit të masave inspektuese dhe afateve për menjanimin e mangësive të konstatuara , inspektorët udhëhiqen nga rëndësia e mangësisë , pasojat e dëmshme të shkaktuara ndaj interesit publik ose ndaj interesit të tretë , si dhe koha e cila është e nevojshme që subjekti i mbikëqyrjes të mënjanojë mangësitë e konstatuara.
- Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese , inspektorët së pari kryejnë funksion preventiv kurse , shqiptojnë masa dhe sanksione inspektuese atëherë kur me funksionet preventive s'mund të sigurohet qëllimi i mbikëqyrjes inspektuese.

II. AKTIVITETET ME DINAMIKË TË PËRCAKTUAR

Inspektorët me qëllim të realizimit të obligimeve të përcaktuara me program janë të obliguar :

- të kryejnë mbikëqyrje të rregullt inspektuese ;
- të kryejnë mbikëqyrje të jashtëzakonshme ;
- të kryejnë mbikëqyrje inspektuese kontrolluese ;
- të kryejnë procedurë inspektimi me përpilim të procesverbalit dhe sjelljes të aktvendimeve tjera në përputhje me dispozitat ligjore ;
- të realizojnë procedurat për barazim , ndërmjetësim dhe meditim , në përputhje me dispozitat ligjore dhe aktet nënligjore ;
- të paraqesë kërkesë për nisjen e procedurës ndëshkimore dhe penale para organit gjyqësor kompetent ose organit ministror përkatës në përputhje me dispozitat ligjore dhe aktet nënligjore ;
- të kryen edukim në përputhje me dispozitat ligjore dhe aktet nënligjore ;
- të parashtron ankesa.

III. INSPEKTORI I AUTORIZUAR PËR NDËRTIMIT

Punët dhe aktivitetet të inspektori të autorizuar ndërtimor në vitin 2020 do të bazohet në kryerjen të mbikëqyrjes inspektuese mbi zbatimin e këtyre ligjeve dhe nënakteve ligjore :

- Ligjit për ndërtim („ Gazeta zyrtare e Republika e Maqedonisë “nr. 130/09, 124/10, 18/11, 36/11, 54/11, 13/12, 144/12, 25/13, 79/13, 137/13, 163/13, 27/14, 28/14, 41/14, 115/14, 149/14, 187/14, 44/15, 129/15, 217/15, 226/15, 30/16, 31/16, 39/16, 71/16 132/16, 35/18, 64/18 dhe 168/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 244/2019);
- Ligjit për mbikëqyrje inspektuese („ Gazeta zyrtare e Republika e Maqedonisë së Veriut“ nr.102/2019) ;
- Ligjin për procedurë të përgjithshme administrative („ Gazeta zyrtare e Republika e Maqedonisë “ nr. 124/15) ;

Parasysh do të merren dhe të gjitha ndryshimet e mundshme në aktet ligjore dhe nënligjore si dhe përgjegjësitë e reja të mundshme .

Lloji dhe fushëveprimi i punëve :

- Ndërtesat e destinuara për arsimin fillor dhe të mesëm ;
- Ndërtesat nga lamia e kulturës ;
- Ndërtesat për nevojat e organeve komunale;
- Ndërtesat e destinuara për mbrojtje primare dhe sekundare ;
- Ndërtesat për nevojat e bashkësive fetare ;
- Ndërtesat industrial ;
- Ndërtesat ekonomike ;
- Ndërtesat afariste ;
- Ndërtesat afariste - banimi ;
- Ndërtesat individuale banimi ;
- Ndërtesat për nevojat të agroberzës ;
- Vilat ;
- Ndërtesat për banim kolektiv ;
- Qendrat tregtare ;
- Hotele ;
- Qendra rekreative ;
- Ndërtesat për veprimtari shkencore - hulumtuese ;
- Garazhë katëshe ;
- Tregje ;
- Rrugë komunale ;
- Objekte përcjellëse shërbyese të rrugëve dhe rrugicave komunale ;
- Mjetet dhe rrjetet të komunikimeve elektronike ;
- Termocentralet dhe hidrocentralet me kapacitet deri në 1 MV ;
- Mulli ;
- Ndërtesat për prodhim të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme me kapacitet deri në 1 MV;
- Largëpërçues me nivelin e tensionit deri në 35 KV ;
- Nënstacionet me nivel tensioni deri në 35 KV ;
- Objektet e magazinimit për produkte të naftës, gazit natyror dhe GLN me kapacitet ruajtje deri në 1.000 ton ;
- Rrjeti sekondar i gazit ;
- Rrjeti sekondar i avullit ;
- Binarët e tranvajit ;
- Ndërtesat e zjarrfikseve ;
- Ndërtesat e mbrojtjes veterinare ;
- Çerdheve të fëmijëve ;
- Ndërtesat në territoret e parqeve nacionale dhe pyjore ;
- Ndërtesat për ndarje të materijaleve për prodhim të betonit ;
- Baza betoni ;

- Baza asfalti ;
- Sitemet lokale të furnizimit me ujë dhe kanalizimet si dhe sitemet për pastrim ;
- Ndërtesat të cilat janë në funksion në mbrojtje dhe promovim të trashëgimisë natyrore (qendra informimi)
- Deponi për mbeturina interne (mbeturinat e ndërtimit) dhe deponi për mbeturina të rrezikshme ;
- Miniera dhe ndërtime për nevojat e minierave ;
- autokampe dhe ndërtesa për nevojat e autokampeve ;
- objektet për ruajtje, trajtimin apo përpunimin e mbetjeve ;
- Stacionet e autobusëve ndërrurban ;
- Kopshte zoologjike ;
- Stadione dhe halla sportive me kapacitet nën 10.000 shikues ;
- Sistemi për vaditje dhe kullim ;
- terreneve të hapura sportive ;
- pishina në nivel të terrenit për përdorim publik ;
- parqet publike ;
- parkingjet publike ;
- ashensorët e skijimit.

Qëllimet dhe joqëllimet të Inspektorit të autorizuar të ndërtimit :

- ✓ Ligjshmëria dhe profesionalizmi i zbatimit të ligjit të të gjithë pjesëmarrësve në çdo fazë të ndërtimit në një objekt ndërtimi , qofshin persona fizikë ose juridikë t'u binden ligjeve që rregullojnë ndërtimin e objekteve ;
- ✓ Inspektori i ndërtimit vepron në mënyrë parandaluese me anë të kontrollimit në kohë të duhur mbi ndërtesat dhe mënyrën e tyre të ndërtimit si dhe marrjen e sanksioneve në se një ndërtesë nuk është kryer në përputhje me ligjet në fuqi ;
- ✓ Aplikimi i ligjshëm i ligjeve për të mbrojtur interesin shtetror dhe interesin e çdo qytetari që merr pjesë në ndërtimin apo është i prekur nga objekti ngjitur me objektin e vet ;
- ✓ Menaxhimin efektiv dhe profesional të procedurave administrative në kohë të përcaktuara me ligj që të të cilat do të përfundojnë brenda afat sa më të shurtër që të jetë e mundur.
- ✓ Inspektori i ndërtimit kryen kontrolla mbi kualitetin e ndërtimit në objektet e ndërtimit me çka zmadhohet kualiteti në ndërtimeve dhe garantohet që ndërtimi ndërtohet në pajtueshmëri me standardet e ndërtimit për tipe të parapërcaktuar të objekteve nga kategoria e 2 e ndërtimit ;
- ✓ Inspektori është i pavarur në marrjen e vendimeve mbi veprimet që duhet të ndërmerren gjatë kryerjes të mbikëqyrjes dhe masat që do të vendosen pas kryerjes të inspektimit ;
- ✓ përcaktimi i masave inspektuese dhe afati i fundit për largimin e mangësive të shkaktuara në drejtim të interesit publik apo interesat e palëve të treta si dhe kohën e nevojshme që subjektin i mbikëqyrjes të korrigjojë mangësitë e hasura ;
- ✓ inspektori në kryerjen e inspektimit mbikëqyerës siguron dëshmi nga detyra zyrtare për kryerjen e procedurës inspektuese.

AKTIVITETI DHE DINAMIKA E VEPRIMIT TË INSPEKTORIT TË AUTORIZUAR TË NDËRTIMIT PËR VITIN 2020 NË VIJIM

Aktivitetet e cila më së shumti kryen inspektori i autorizuar i ndërtimit janë :

- kontroll mbi ndërtimin e objekteve në vendndodhje, shqyrtimin e të dhënave dhe provat për ndërtimi që përcakton nëse ajo është e ndërtuar me respektimin të ligjeve që rregullojnë ndërtimin e objektit, në bazë të sëcilave miratohet Vendimi mbi nevojën për drejtimin procedurë administrative apo jo, e njëjta kryhet edhe me Procesverbalin e përgatitura në vendndodhje;

Periudha e realizimit : Në kontuitet gjatë tërë vitit

- > punë në zyrë në Lëndët për të cilët është filluar procedurë inspektuese, për shkak të parregullsive në ndërtimin e objektit ;

Periudha e realizimit : Në kontuitet gjatë tërë vitit

- > pritja e palëve - personave që kanë nevojë për njohjen e Ligjit për ndërtimin, mënyra për të përmbushur kërkesat e ligjeve që rregullojnë ndërtimin e një objekti ;

Periudha e realizimit : Në kontuitet gjatë tërë vitit

- > pranimi e dokumentacionit në formën e një aplikimi iniciativë, fletëparaqitje, kërkesë dhe pranimi i personave të cilët gojarisht japin - paraqesin shkelje në ndërtim në ndonjë objekt dhe kërkohet të kryet kontrollë në vendndodhje ;

Periudha e realizimit : Në kontuitet gjatë tërë vitit

- > dhënja e përgjigjive të korrespondencave dhe ankimeve , ridërgimi i dokumentacioneve tek organet tjera, ankimim me organe tjera, përgaditja informatash , ridërgime të ankesa si dhe përgjigje tek personat fizik dhe juridik të cilët kërkojnë informacijone në lidhje me një procedure të caktuar administrative ;

Periudha e realizimit : Në kontuitet gjatë tërë vitit

- > njëra nga aktivitetet kryesore të cilës Inspektori i autorizuar i ndërtimit duhet t'i jap më shumë rëndësi gjatë vitit 2020 është kontrolli e kualitetit të ndërtimit të objekteve për të cilat Njësia e urbanizmit, mjedisit jetësor dhe NJVL e Komunës Dibër ka dorëzuar një akt me të cilin konfirmohet : Leje ndërtimi, Leje për rindërtimin dhe rehabilitimin - sanimin e objektit të aplikimit.

Periudha e realizimit : Në kontuitet gjatë tërë vitit

- > në vitin 2020 njëra nga aktivitetet bazë dhe të përforcuar të Inspektorit të autorizuar të ndërtimit do të jetë kontrolli e të gjithë pjesëmarrësve në ndërtimin e një objekti ndërtimor të cilët duhet të plotësojnë disa kriteret , standard dhe duhet të kenë licenca për kryerjen e aktiviteteve të këtij lloji, nga faza e projektimit deri në fazën e dorëzimit të objektit në përdorim - shfrytëzim.

Periudha e realizimit : Në kontuitet gjatë tërë vitit

- > kontrollimi i personave fizik dhe juridik të cilët kanë vendosur paisje urbane në sipërfaqet publike (nëse të njëjtët posedojnë leje për vendosjen dhe nëse paisja urbane është e vendosur në pajtim me Lejen e dhënë)

Periudha e realizimit : Në kontuitet gjatë tërë vitit

- > mbajtje të regjistrit , librit protokollar dhe librit ndërtimor ;

Periudha e realizimit : Në kontuitet gjatë tërë vitit

- > një aktivitet shumë i rëndësishëm i inspektorit ndërtimor për vitin 2020 është kontrollin gjithëpërfshirës të dokumentacionit teknik - ndërtus dhe kontrollin Lejeve të ndërtimit të lëshuara në Njësia e Planifikimit Urban në Komunën e Dibrës me çka rritet cilësia e punës së Njesisë dhe kontrollimi i korrektësisë - saktësinë e Lejeve e të lëshuar, ky aktivitet vazhdon

gjatë gjithë vitit, vëllimi varet nga numri i Lejeve të lëshuara për ndërtim dhe Vendim për ndërtim për objekte për të cilat nuk jepet Leje ndërtimi.

Periudha e realizimit : Në kontuitet gjatë tërë vitit

- > Njësia për mbikëqyerje inspektuese do ta realizojë këtë program me 1 (një) Inspektor të autorizuar të ndërtimit , për të zbatuar këtë materialin - program janë të nevojshëm mjete materijalo - teknike dhe kushtet e tjera, dhe atë :
 - Automjet , fotoaparar , telefon mobil si dhe angazhimin e institucioneve tjera profesionale për shkak të përmisimit të aktiviteteve të përditshme.

Për të gjitha ato që nuk janë të përfshira në këtë program do të zbatohen aktet ligjore dhe nënligjore në këtë fushë-lami.

IV. AKTIVITETET ANALITIKE - INFORMATIVE

- përgaditjen e raporteve javore dhe mujore ;
(afati : në vazhdimësi gjatë gjithë vitit)
- përgaditjen e raporteve sa më cilësore në përputhje me dispozitat ligjore dhe publikimi i tyre në faqen e internetit (VEB faqen) të komunës së Dibrës ;
(brenda - afati muajve : janar , prill , korrik dhe tetor)
- Raporti vjetor i inspektorëve të autorizuar në mënyrë individuale për vitin 2019
(afati i dorëzimit deri më 01.03.2020)
- Përgatitja e Projekt programit të punës së Inspektorëve të autorizuar për çdo njërin individualisht për vitin 2020
- Përgatitja e Programit të punës së Njesisë mbikëqyerse inspektuese për vitin 2020

V. BASHKËPUNIMI ME ORGANET TJERA NË KRYERJEN E INSPEKTIMEVE

Gjatë inspektimit inspektorët e autorizuar do të bashkëpunojë me :

- Ministrine e punëve të mbrendshme - NJPB Dibër ;
- Stacioni policor - shërbimi rrugëve të sigurisë dhe në inspektimit të rregullt sipas dispozitave të Ligjit për transportin rrugor ;
- Inspektoriati shtetror për transport dhe lidhje ;
- Inspektoriati shtetror për ndërtim dhe urbanizëm ;
- Inspektoriati shtetror komunal ;
- Sektori për urbanizëm , mjedisit jetësor , zhvillimit ekonomik lokal , punë komunale , komunikacioni dhe rrugët në Komunën Dibër ;
- Sektor dhe njësi të tjera pranë Komunës Dibër ;
- Institucionet profesionale dhe shkencore si dhe subjektet e tjera ligjore në zbatimin e procedurës ; dëshmuese
- Bashkëpunimi me organet dhe institucionet tjera profesionale për sigurimin e provave për zhvillimin e procedurës administrative

Kryetari i Komunës Dibër
Hekuran Duka

